



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of Generaly Secretary

DATE/A:	22.02.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komuna Fushë Kosovë
CC:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Fushë Kosovës për Taksat për Leje Ndërtimore për vitin 2018 me Nr.Protokolli 17/18 të datës 04.01.2018

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 04.01.2018 me numër protokolli 17/18, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës për vitin 2018 nga Komuna e Fushë Kosovës (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit e llogaritur nga Komuna është **2.25 €/m²** (dy euro e njëzetë e pesë centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 te UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja te banimit, konform formulës se përcaktuar ne nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat për lëshimin e lejes së ndërtimit në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1